



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:249981

Datë: 06.11.2023

Numri i dokumentit: 04879658

**P.nr.889/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit N.R. nga O., i akuzuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.720/2021 të datës 10.11.2021, në seancën e shqyrimit filletar publik të mbajtur me datë 27.10.2023, në pranin e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, i akuzuarit N.R. dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare av. Beshir Zani, me datë 31.10.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 06.11.2023 përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

N.R. i biri i E. dhe nëna V., e gjinisë M., i lindur me ..., në M. KK O., me vendbanim në M.KK O., me numër personal ... të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, penzioner, e gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 22.06.2021, rrëth orës 18:50, në fshatin M. Komuna e O., pjesëtaret e Njësisë së hetimeve të stacionit policor në Obiliq, pasi kanë pranuar informatën se i pandehuri posedon armë në shtëpi, me rastin e kontrollit në shtëpinë e tij, i kanë gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri pushkë gjuecie të tipit "Z.", me numër serik ... kalibër .. së bashku me gjashë(..) copë fishek, ..., kalibër ... dhe një pistoletë me mbishkrimin "..." me numër serik ..., të cilat i pandehuri po i mbante në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët Nr.05/L022.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 366 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

- I. Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, të akuzuarit N.R. Gjykata i shqipton dënim me gjobë në vlerë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) €uro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i pandehuri që konform nenit 43 par.2 të KPRK-së, dënimin e lartëcekur ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që njëzet (20) Euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim.
- III. Gjykata në mbështetje të nenit 277 par.1 të KPPRK-së si dhe nenit 366 par.3 të KPRK-së, URDHËRON konfiskimin e përhershëm të armëve: pushkë e gjuetisë e tipit “...” me numër serik ... kalibër ... , ... copë fishek, ..., kalibër .. dhe pistoletë me mbishkrimin “...” me numër serik ... dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, armët e përshkruar më lartë, të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.
- IV. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimate të krimtit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.720/2021 të datës 10.11.2021, ndaj të akuzuarit N.R. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrimit fillostar me datë 27.10.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Besnik Jakupi, të akuzuarit N.R. dhe mbrojtësi e tij sipas detyrës zyrtare av. Beshir Zani, ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, deklaron se pushkën e gjuetisë e ka pasur me leje mirëpo për shkak të gjendjes shëndetësore dhe operacioneve që ka pasur nuk kam arritur të vazhdoj lejen për këtë arme, ndërsa për arma e tjera ka qenë e papërdorshme. Është hera e parë që jam para gjykatës dhe asnjëherë nuk kam qenë i dënuar ose i hetuar për ndonjë vepër penale. Kërkon nga gjykata të shqiptoj një dënim sa më të butë marr parasysh që jam penzioner dhe mbajtës i familjes, ndërsa mbrojtësi e tij ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësinë, pasi që pranimi i tillë është bërë vullnetarisht dhe pa presion dhe pas konsultimit me mua si mbrojtës, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe benefitet e tjera, i kërkon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënit, të marrë parasysh

që i mbrojturi im nuk ka rënë ndesh me ligjin me herët, që është i moshës së shtyrë po ashtu edhe mbajtës i familjes, që ndaj të pandehurit të shqiptojë një dënim me gjobë.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit te prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga i pandehuri pasi që një pranim i tillë bëhet ne mënyrë vullnetare, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike të përshkruar si ne aktakuzë. Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnje presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat e pranimit te fajësisë për të cilat është njofuar nga Gjykata, , si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 te KPPRK-se janë përbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnje rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënitit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2021-AJ-0167 i datës 22.06.2021; Raporti i Policit A. C. #..., i datës 22.06.2021; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin N.R., i datës 08.11.2021, dhënë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin F.R. i datës 22.06.2021 dhënë në Stacionin Policor në Obiliqi; Prosesverbal për kontrollin dhe sekuestrim të përkohshëm i datës 22.06.2021; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 22.06.2021; si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit N.R. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënitit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese ne kuptim te nenit 70 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte. Gjithashtu i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën qe e ka kryer, po ashtu i njëjti ka moshë të shtyrë. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 48 te KPRK-se te akuzuarin e gjykoj si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet edhe qëllimi i dënitit. Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënim i shqiptuar te akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënitit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen veçanërisht

llojin e njëjtë të veprës penale, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimtit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, gjykata ndaj të akuzuarit ka shqiptuar edhe dënimin plotësues ashtu që ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armëve të përshkruara më lartë.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.889/23 më datë 06.11.2023**

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

**Albrim Kastrati**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.